



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT
Sektori pronëso-ro-juridik

Datë	07.08.2019
Referenca	01-463-53903
Për	Fatime Mustafa, Av.Publike Komunale
Nëpërmjet	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
Nga	Lumnije Ejupi, Shefe e Sektorit
Lënda	Dërgimi i shkresave të lëndëve për fillimin e procedurës përmbartimore

Komuna e Lipjanit bazuar në Vendimet Përfundimtare: Nr.05/200 dt.15.10.2014, Nr.03/30 dt.20.05.2015, Nr.08/1144 dt.04.05.2017, Nr.08/144 dt.04.05.2017 dhe Akt-Vlerësimeve, ka dorëzuar dokumentet e kërkuara në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë-Departamenti i Shpronësimi për kompensimin e pronave të paluajtshme në kuadër të projektit, për ndërtimin e Autostradës R6 Prishtinë-Hani i Elezit, Sektori C1 dhe C2 përfshirë Zonat Kadastrale: Konjuh, Lipjan, Marec, (shenim: pranuar nga organi i cekur më lartë nr.ref 6138/14 dt.24.12.2014, nr.ref. 4086/15 dt 12.08.2015, nr.ref.464-29356 dt.13.06.2017).

Ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 të Ligjit Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/1-205, shuma e kompensimit të shpronësimit e përcaktuar me Akt-Vlerësim-Vendim Përfundimtar Nr.05/200 datë 15.10.2014, Akt-Vlerësim-Vendim Përfundimtar Nr.03/30 datë 20.05.2015 dhe Akt-Vlerësim-Vendim Përfundimtar nr.08./144 të datës 04.05.2017, pagesa e kompensimit duhet të bëhet plotësisht brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi e Vendimit, ndërsa deri tani kanë kaluar tri (4) vite nga pranimi i dokumenteve për kompensim nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë-Departamenti i Shpronësimi.

Përkitazi me të dhënat e më sipërme organi ynë ka bërë kërkesë me datë 04.08.2017 nr. Ref.1-464-42384 për kompensimin e pronave të paluajtshme të Komunës së Lipjanit, pranuar nga Departamenti Shpronësimit me datë 09.08.2017 poashtu, me datë 23.11.2018 nr.1-941-70757 kemi bërë përseritjen e kërkesës për kompensimin e pronave të paluajtshme të Komunës së Lipjanit, të pranuar nga MMPH Prishtinë me datë 26.11.2018, por deri me tani nuk kemi marr përgjigje nga pranimi i dokumenteve për kompensim nga organi i cekur më lartë.

Andaj bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.3/31 janar 2013, të fillohet procedura përmbartimore për kompensimin e parcelave kadastrale të shënuar në formë tabelare si në vijim:

Nr.	Pronar	Certifikatë Njësia kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe e përgjithshme m ²	Sipërfaqja e shpronësuar m ²	Pagesa për kompensim
1	P.Sh Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409036-00263-1	Konjuh	12865 m2	3740m2	142.120.00€
2	P.Sh.KK Lipjan shfryt.99 vite NTG”Blendi”	P-71409036-00263-2	Konjuh	8173 m2	20 m2	760.99€
3	P.Sh.KK Lipjan shfryt.99 vite NNSh”Terma”	P-71409036-00263-3	Konjuh	9780 m2	2144 m2	89,872.00€
4	P.Sh.Rrugë publike,KLipjan	P-71409044-01583-0	Lipjan	7112 m2	255 m2	1,275.00€
5	P.Sh.Rrugë publike,KLipjan	P-71409044-01581-0	Lipjan	4972 m2	630 m2	12,600.00€
6	P.Sh Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409044-00181-0	Lipjan	7270 m2	434 m2	2,170.00€
7	P.Sh.Rrugë publike,KLipjan	P-71409054-00077-0	Marec	3864 m2	238 m2	714.00€
8	P.Sh.e ujërave,K K Lipjan	P-71409054-00707-0	Marec	7203 m2	233 m2	699.00€
9	P.Sh e rrugëve - Lipjan	P-71409054-00708-0	Marec	12771 m2	308 m2	1,540.00€
10	P.Sh e rrugëve - Lipjan	P-71409054-00710-0	Marec	6118 m2	372 m2	1,860.00€
11	P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409054-00639-0	Marec	1463 m2	173 m2	865.00€
12	P.Sh e rrugëve - Lipjan	P-71409054-00640-0	Marec	1205 m2	116 m2	580.00€
13	P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409054-00641-0	Marec	2738 m2	183 m2	915.00€
14	P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409054-00042-0	Marec	312 m2	197 m2	591.00 €
						Shuma për kompensim 256,561.99 €

Bashkangjitur me këtë shkresë iu dërgohen shkresat përcjellëse të cilat i janë dërguar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë Departamentit të Shpronësimit.

Shtojcë:

- **Certifikatë –Njësia Kadastrale për zonat kadastrale Konjuh, Lipjan dhe Marec (orgjinal)**
- **Akt-Vlerësimet e MMPH-së (kopje)**